

Komunitetet e papërgatitura përballë fatkeqësive natyrore

Fatkeqësitë janë ngjarje komplekse dhe problemi parandalimit dhe i zbutjes së efekteve të tyre ka shumë aspekte, ku padyshim aspekti i informimit dhe i ndërgjegjësimit për to është një nga më kryesorët.

Por sa di publiku për situatat e emergjencave civile dhe sistemin e paralajmërimit të hershëm? Në kuadër të programit PRO NEËS, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri realizoi një anketim me temë kryesore “Risku është fat apo zgjedhje”. Anketimi mbarëkombëtar solli një pamje interesante të asaj çka njerëzit dinë apo nuk dinë mbi këto çështje.

Më shumë se 85% e të anketuarve pohojnë që i njohin rreziqet që mund të prekin komunitetin e tyre, por ata nuk kanë dijeni për planet e emergjencës në zonën e tyre. Rreth 86% e tyre nuk e dinë çfarë përfaqëson Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm apo se cilat janë mjetet e komunikimit të këtij sistemi në nivel kombëtar dhe vendor.

Të pyetur mbi shkaktarin kryesor të fatkeqësive që ndikojnë tek ata dhe komuniteti i tyre, shumica mendon se shkaku kryesor janë ndryshimet dhe ndërhyrjet e bëra nga njeriu, dhe vetëm 6.5 % të të anketuarve referojnë shkaqet natyrore.



Programi për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe parandalimin e përmbytjeve në Shqipëri

Sipas 66.5 % të të anketuarëve, burimi kryesor i informacionit për të mësuar rreth rreziqeve dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm është media, ndërsa 55% e tyre renditën edukimin në shkollë si mënyra më e mirë për të mësuar për emergjencat civile.

Një pyetje e veçantë në pyetësor - Nëse risku është fat apo zgjedhje? - kishte si qëllim të kuptuarit më mirë të situatave të emergjencave civile në Shqipëri. Rreth 40.6% e të anketuarëve mendojnë që risku është fat, kurse 59.4% mendojnë se ai është çështje zgjedhje.

Përditshmëria jonë na prezanton me një sërë zgjedhjesh të pafundme dhe peshimi i risqeve dhe i përfitimeve relative nuk është aspak e lehtë. Ne mund të mbështetemi vetëm tek njohuritë që kemi. A keni menduar ndonjëherë se si do të reagonit ndaj një emergjence? Asnjërit nga ne nuk i pëlqen ta mendojë një gjë të tillë, por si qytetarë ne duhet të kemi informacionin bazë mbi rreziqet dhe masat e duhura që duhet të ndërmerrem, jo vetëm për të parandaluar fatkeqësitë, por edhe për t'u përballur me to nëse ato ndodhin.

Në këtë numër:

“Të gjitha palët të bashkojmë forcat për pjesëmarrje aktive në zbatimin e programit”



Në Ditën e Evropës PRO NEWS bëhet pjesë e festimeve



“Të gjitha palët të bashkojmë forcat për pjesëmarrje aktive në zbatimin e programit”

Takimi i katërt i Komitetit Drejtues të Programit PRO NEWS

Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe parandalimin e përmbytjeve në Shqipëri (PRO NEWS) mbledhi takimin e katërt të Komitetit Drejtues, më 11 Prill 2018, në Tiranë.

Takimi, i organizuar nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes në Shqipëri përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), kishte për qëllim diskutimin e progresit të programit dhe planin e punës për periudhën e mbetur të zbatimit (Prill – Nëntor 2018).

Fjalët përshëndetëse në hapje të takimit u mbajtën nga z. Shemi Prenci, Drejtor i Përgjithshëm i DPEC-së, znj. Olga Luisa Anghelakis, shefe e Sektorit të Qeverisjes Ekonomike në Delegacionin e BE-së në Shqipëri, z. Hubert Grandjean, Oficer i Programit në Delegacionin e BE-së në Shqipëri dhe z. Giovanni de Siervo, Drejtor Programi PRO NEWS, Departamenti Italian i Mbrojtjes Civile.

Në fjalën e hapjes, z. Shemi Prenci, Drejtor i Përgjithshëm i DPEC-së, theksoi se “anëtarësimi i Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së është tashmë një prioritet për Qeverinë Shqiptare, çka kërkon si parakusht edhe zbatimin e suksesshëm të programit PRO NEWS”.

“Të gjitha palët në këtë moment duhet të bashkojnë forcat për të kapërcyer sfidat dhe për të marrë pjesë aktive dhe intensive në zbatimin efektiv të programit. Nuk kemi kohë për të humbur, sikurse nuk mund të

pranojmë apo dhe të shkaktojmë dështimin e programeve të tilla me rëndësi madhore për mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve të saj”, shtoi ndër të tjera z. Prenci.

Znj. Olga Anghelakis, shefe i Sektorit të Qeverisjes Ekonomike në Delegacionin e BE në Shqipëri, theksoi se “Programi PRO NEWS është thelbësor në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian”. “Suksesi i zbatimit të programit varet nga përfshirja e plotë e të gjithë përfituesve, prandaj të gjitha palët duhet të përpiqen të sigurojnë të gjithë mbështetjen e nevojshme për zbatimin e aktivitetëve”, theksoi znj. Anghelakis në fjalën e saj.

Z. Hubert Grandjean, Delegacioni i BE në Shqipëri, bëri thirrje për më shumë bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet të gjithë institucioneve kryesore përfituese shqiptare dhe partnerëve të Konsorciumit, në mënyrë që të arrihen objektivat e programit dhe, si rrjedhim, të përforcohet Sistemi Shqiptar i Mbrojtjes Civile.

Z. Giovanni De Siervo, Drejtor i Programit në Departamentin Italian të Mbrojtjes Civile, në emër të Konsorciumit zbatues, vlerësoi angazhimin e institucioneve shqiptare dhe sidomos të DPEC-së për koordinimin e siguruar ndërmjet të gjithë aktorëve kombëtarë dhe konfirmoi angazhimin nga të gjithë partnerët e konsorciumit drejt zbatimit të suksesshëm të programit. Z. De Siervo theksoi rëndësinë e faktit që të gjithë përfituesit të jenë më shumë bashkëpunues, për të arritur së bashku objektivat e programit.

Partnerët e programit PRO NEWS prezantuan progresin e secilit komponent teknik deri më tani. Diskutimet u përqëndruan në qasjen e parashikuar për arritjen e rezultateve të pritura, aktivitetet e planifikuara, fushat që kanë nevojë për vëmendje dhe rekomandimet për rrugën përpara.





Në Ditën e Evropës *PRO NEWS bëhet pjesë e festimeve*

Në Ditën e Evropës (9 maj), Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Shtetet Anëtare organizuan një sërë aktivitetesh festive, pjesë e të cilave ishte dhe Fshati i BE-së, i pozicionuar në qendër të qytetit të Tiranës, në sheshin "Skënderbej".

Në këtë aktivitet merrnin pjesë të gjitha projektet e financuara nga BE në Shqipëri. Të shpërndarë nëpër tendat e shumta që krijonin ambjentin e një 'fshati', projektet prezantonin punën e bërë sipas tematikave përkatëse kushtuar mjedisit, kulturës dhe edukimit, zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë, qytetarisë evropiane, të drejtave të njeriut dhe shërbimeve publike, por jo vetëm.

Pjesë e këtij panairi u bë edhe programi PRO NEWS "Përmirësimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimit të Përmbytjeve në Shqipëri", përmes një mori materialesh dhe aktivitetesh dedikuar tërësisht paralajmërimin në kohë dhe marrjes së masave të duhura për përballimin e rrezikut në rast fatkeqësie natyrore, siç janë përmbytjet. Slogani i përdorur në këtë ditë, njëkohësisht dhe slogan i fushatës së ndërgjegjësimit të programit, është "Risku nuk është fat, është zgjedhje!".

Kuriozitet të veçantë për vizitorët ngjalli stacioni meteorologjik i ngritur enkas në shesh për të demonstruar matjet e vazhdueshme të lartësisë dhe të intensitetit të reshjeve, duke njohur në kohë reale të dhënat e motit. Fëmijët dhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare të përfshirë në aktivitet, u bënë pjesë e lojës "në shesh", e krijuar si një mjet mësimor mbi fazat e ndryshme të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Ishin të shumtë njerëzit që plotësuan pyetësorin në lidhje me fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile, i cili synon të vlerësojë njohuritë mbi rrezikun dhe të kuptojë se si njerëzit perceptojnë rrezikun në rast të një fatkeqësie. Vëmendjen e qytetarëve që vizitonin fshatin e BE-së e tërhoqi dhe ekspozita me foto dhe rishikime historike të ngjarjeve më të fundit të përmbytjeve në Shqipëri, e ideuar me qëllimin për të treguar dhe për të kujtuar se sa shpesh mund të ndodhë një fatkeqësi natyrore në Shqipëri dhe pasojat që mund të shkaktojnë ajo.

Organizatrat pjesëmarrëse patën mundësi të diskutonin dhe të shkëmbenin përvojat e tyre në këndin e folësve të BE-së. Programi PRO NEWS u prezantua nga z. Shemsi Prençi, Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, i cili e vuri theksin në informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit lidhur me riskun në rast fatkeqësie natyrore dhe reagimin në kohën e duhur.

Workshop kombëtar për Udhëzimet e reja dhe Planifikimin e Emergjencave 28 Qershor 2018, Durrës, Shqipëri

Përfaqësues nga Prefekturat e Shqipërisë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC) dhe aktorë të tjerë kombëtarë të përfshirë në Planifikimin e Emergjencave në Shqipëri, së bashku me Partnerët e Konsorciumit (DPC, CIMA, REC) u mbledhën në një workshop kombëtar lidhur me Udhëzimet e reja dhe Planifikimin e Emergjencave, më 28 Qershor 2018.

Qëllimi i këtij workshopi ishte prezantimi i versionit përfundimtar të Udhëzimeve për Planifikimin e Emergjencave në nivel Prefekturë, përgatitur nga grupi i ekspertëve të programit (CIMA dhe REC), në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Prefekturave të Shqipërisë, përgjegjës për emergjencat civile.

Nëpërmjet prezantimeve dhe sesioneve interactive, pjesëmarrësit patën mundësi të rishikojnë planet për të verifikuar kohezionin e plotë të strukturës së tyre me udhëzimet e PRO NEWS; duke vazhduar më pas me zhvillimin e një modeli të koordinuar për aktivizimin e fazave operacionale dhe identifikimin e shkaktarëve të mundshëm – si në fazën e parashikimit dhe të monitorimit – në dispozicion të sistemit të Mbrojtjes Civile të Shqipërisë.

Përgjatë muajit shtator janë planifikuar të organizohen disa takime rajonale për të finalizuar modelimin e Planeve të Emergjencave.



Ndiqni programin në:

 www.pronewsprogramme.eu

 www.facebook.com/ProNewsAlbania

 twitter.com/PronewsAlbania